1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi**

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: *“Hartim Projekti “Rrjeti i funizimit per ujitjen e zones se Dumresë”.*

Afatet e ekzekutimit: 6 muaj nga momenti i nenshkrimit te kontrates

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: *sipas detyres se projektimit*

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

DETYRË - PROJEKTIMI

PËR HARTIMIN E PROJEKTIT:

Objekti: “Hartim i Projektit për Rrjetin e Furnizimit për Ujitje i Zonës së Dumresë”

1. QËLLIMI I PROJEKTIT

Qëllimi kryesor i projektimit të rrjetit vadtës është krijimi i një sistemi funksional dhe të qëndrueshëm që garanton furnizimin e rregullt me ujë të sipërfaqeve bujqësore, në përputhje me nevojat ujore të kulturave dhe kushtet klimatike të zonës.

Në mënyrë të veçantë, projektimi synon:

- Sigurimin e sasisë së nevojshme të ujit në kohën e duhur për zhvillimin normal të kulturave bujqësore
- Rritjen e rendimentit dhe cilësisë së prodhimit bujqësor
- Përdorimin racional dhe eficient të burimeve ujore
- Reduktimin e humbjeve të ujit gjatë transportit dhe shpërndarjes
- Garantimin e presioneve dhe prurjeve të nevojshme në çdo pikë të rrjetit
- Përmirësimin e menaxhimit dhe kontrollit të vadtjes
- Mbrojtjen e tokës dhe mjedisit nga degradimi, erozioni dhe kripëzimi
- Sigurimin e qëndrueshmërisë teknike dhe ekonomike të sistemit në afat të gjatë

Projektimi i rrjetit vadtës përbën një element kyç për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë ushqimore dhe zhvillimin rural.

2. KUADRI LIGJOR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si dhe nenit 20 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, me Vendim Nr. 377, datë 12.6.2024 Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 408, Datë 13.5.2015, Të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”,

Projektuesi duhet të kryejë të gjithë punën në përputhje me standardet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. VENDNDODHJA DHE PËRSHKRIMI I ZONËS

Zona e marrë në studim për hartimin e projektit vaditës ndodhet në një territor me përdorim kryesisht bujqësor. Sipërfaqja e zonës karakterizohet nga terren kryesisht i sheshtë, me pjerrësi të vogël, çka krijon kushte të favorshme për ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve të vaditjes me gravitetose me presion.

Nga pikëpamje pedologjike, tokat e zonës janë me strukturë mesatare, me përbërje argjilore, dhe paraqesin aftësi të mirë për mbajtje të ujit, duke qenë të përshtatshme për kultivimin e kulturave bujqësore të ndryshme. Megjithatë, mungesa e reshjeve gjatë periudhës së vegjetacionit krijon nevojë për aplikimin e vaditjes së kontrolluar.

Zona karakterizohet nga klimë mesdhetare me ndikime kontinentale, me temperaturat e lartë gjatë muajve të verës dhe reshjet e pamjaftueshme e të shpërndara në mënyrë jo të barabartë gjatë vitit. Këto kushte klimatike e bëjnë të domosdoshëm sigurimin e ujit për vaditjen e periudhat kritike të zhvillimit të kulturave bujqësore.

Burimi i ujit për vaditje parashikohet të jetë (lumë/kanale ekzistues/pus ithellë/rezervuar artificial), i cili ofron aftësi të pamjaftueshme uji për të përmbushur kërkesat ujore të sipërfaqes së projektuar. Aktualisht, infrastruktura vaditëse është e pamjaftueshme ose e amortizuar, duke justifikuar nevojën për projektimin e një sistemi të rivaditjes me efikasitet të lartë.

Qëllimi i këtij projekti është projektimi i një sistemi vaditës funksional dhe ekonomik, i cili do të sigurojë shpërndarje të njëtrajtshme të ujit, reduktim të humbjeve dhe rritje të rendimentit bujqësor, duke respektuar kushtet teknike, ekonomike dhe mjedisore të zonës.

4. GJENDJA EKZISTUESE

Aktualisht, zona nuk disponon një veper të mirë organizuar, por një kanale të amortizuara dhe vaditja ndodh në mënyrë të çrregullt dhe me efikasitet shumë të vogël për disa arsye:

- Humbje Hidraulike sa i përket prurjes
- Humbje Hidraulike sa i përket presionit
- Mungesa e sasise së ujit
- Mungesa e rezervuarëve rregullues të kërkesës për ujë
- Gjendjes jo të mirë të veprave inxhinierike

Këto problematika e bëjnë të domosdoshëm ndërtimin e një sistemi të ri vadites dhe të projektuar sipas standardeve teknike bashkohore europjane.

5. ASPEKTE TEKNIKE

Projekti duhet të parashikoj ndërtimin e një stacioni pompimi, linje transmetimi , rezervuari akumulues për rregullimit e prurjes si dhe rrjetin shpërndares të vaditjes:

Për

- Sipërfaqen e zones së interesit
- Llojin e kulturave bujqesore që do të mbjellem
- Sasia e prurjeve të ujit nga burimi
- Koeficientin e rrjedhjes dhe filtrimit
- Llogaritjet hidraulike të linjave si dhe dimesionimi i tyre
- Llogaritjet e sasise së rezervuarit
- Llogaritjet hidraulike të stacionit të pompimit së bashku me prametrat energjitik
- Llogaritjet e kërkeses për uje të kulturave bujqesore sipas hidromoduleve përkatese

6. KONKLUZIONE

Ndërtimi i kanalit duhet të ketë ndikim pozitiv dhe gjatë ndërtimit duhet të minimizojnë **Përfitime bujqësore**

- Rritje e ndjeshme e rendimentit të kulturave
- Mundësi për kultura me vlerë më të lartë (perime, fruta, sera)
- Stabilitet i prodhimit edhe në vite të thata
- Përmirësim i cilësisë së prodhimit bujqësor

Përfitime ekonomike

- Rritje e të ardhurave për fermerët
- Ulje e rrezikut ekonomik nga thatësitat
- Krijim i vendeve të reja të punës (ndërtim, mirëmbajtje, bujqësi)
- Zhvillim i ekonomisë lokale dhe rurale
- Rritje e vlerës së tokës bujqësore

Përfitime teknike dhe infrastrukture

- Shfrytëzim më efikas i burimeve ujore
- Ulje e humbjeve të ujit krahasuar me sistemet e vjetra
- Automatizim dhe kontroll më i mirë i vaditjes
- Jetëgjatësi më e madhe e sistemit

Përfitime mjedisore

- Përdorim racional i ujit
- Parandalim i degradimit të tokës dhe kripëzimit
- Reduktim i erozionit
- Menaxhim më i mirë i ujërave sipërfaqësore

Përfitime sociale

- Përmirësim i kushteve të jetesës në zonat rurale
- Frenim i emigrimit nga fshati
- Bashkëpunim më i mirë mes fermerëve për menaxhimin e ujit

- Siguri ushqimore më e lartë
- Përfitime afatgjata strategjike
- Përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike
- Qëndrueshmëri e prodhimit bujqësor
- Zhvillim i balancuar rajonal.

7. HARTA E POZICIONIMIT

Objektivi i detyres së projektimit I Ndertimi I Sistemit Vadites Me Sisteme Pompash Dhe Depo Shpermdarjeje me Linja Me Vete Rrjedhje. Ky projek konsiston ne shtimin e kapacitetit ujites te zones se dumrese ne 4800ha

Linja kryesore nga stacioni i pompave tek depoja kryesore

Linja nr.1 nga depoja kryesore tek fshati Qafeshkalle, poshte majes se Granices

Linja nr.2 nga depoja kryesore tek fshati Çestije, poshte majes se Bardhe.

Linja nr.3 nga depoja kryesore tek fshati Dëshiran, poshte majes se Madhe.

- Linja kryesore, Stacion Pompash – Rezervuari kryesore

Nga stacioni i pompave parashikohet qe do te jete ne lumin Devoll sipas skemes bashkengjitur deri tek rezervuari kryesore ne kuoten +288m. Mbi fshatin Floq

Vepra marrjes do te parashikohet ne dy varjante :

- 1- Me veper marrjeje afersi te derdhjes se liqenit te Banjes dhe me pas me kanal deri ne fshatin Floq ku parashikohet te jete stacioni i pompave.
- 2- Me veper marrjeje dhe stacion pompash ne fshatin Floq.

Varjanti me ekonomik do te procedohet.

- Dega kryesore nr.1, nga rezervuari kryesore – maja e Granices.

Kjo linje kalon nga nga rezervuari ne lumin Devoll ne afersi te fshatit Lumas, me pas vazhdon ne afersi te liqenit te Kashtes dhe liqenit te Thate, per te ndjekur me pas gjurmen ndermjet Belshit dhe fshatit Trojasi duke perfunduar ne afersi te fshatit Qafeshkalla poshte majes se Granices. Ku do te vendoset rezervuarit nr.1 ne kuoten +250m. Kjo dege parashikohet te jete me nje gjatesi L=14560ml

Kjo dege do te furnizojë me uje ndermjet linjave terciare tokat dhe liqenet (para fillimit te sezonit te ujitjes dhe ne perjudhat qe nuk perdoret uji per ujitje) ne drejtimin e gjurmes se saj.

Kjo linje mund te furnizojë liqenet e me poshtem:

- | | |
|-----------------------------|-------------------------|
| ➤ Liqeni i lagjes Shales | ➤ Liqeni i Gjormulles |
| ➤ Liqeni i Kashtes | ➤ Liqeni i Skillapit |
| ➤ Liqeni i Thate | ➤ Liqeni i Tudes |
| ➤ Liqeni Strehes | ➤ Liqeni i Gropa e Kuqe |
| ➤ Liqeni i Gjate | |
| ➤ Ujembledhesii Qafshkalles | |

- Dega kryesore nr.2, nga rezervuari kryesore – poshte majes se Bardhe.

Kjo linje kalon nga nga rezervuari ne lumin Devoll ne afersi te fshatit Lumas, ku deri ne afersi te lagjes Shalsi shkon paralel me dy deget e tjera nr.1 dhe nr.3 me pas vazhdon gjurmen per ne Liqenin e Forces, kalon ne afersi te fshatit Gradishte me tej afer liqenit te Golloces, pastaj ne afersi te liqenit te Cestijes duke perfunduar ne afersi te fshatit Çestije poshte majes se Bardhe ne kuton +230m ku do te pozicionohet rezervuari i nr. 2. Gjatesia e kesaj linje parashikohet te jete L= 18100ml.

Kjo dege do te furnizojë me uje ndermjet linjave terciare tokat dhe liqenet (para fillimit te sezonit te ujitjes dhe ne perjudhat qe nuk perdoret uji per ujitje) ne drejtimin e gjurmes se saj.

Kjo linje mund te furnizojë me ane te linjave terciare liqenet e me poshtem:

- | | |
|---------------------|--------------------|
| ➤ Fusha e Turbullit | ➤ Liqenin e Pacit |
| ➤ Liqeni i Forces | ➤ Liqenin e Qulles |

-
- Liqeni i Cibiles
 - Liqeni i Gjelavures
 - Liqeni i Shurit
 - Liqeni i Shkozës
 - Ujëmbledhësi i Plevicës
 - Liqeni i Merhajes
 - Liqeni i Gjazes
 - Liqeni i Ltomithit
 - Liqeni i Kuq
 - Liqeni i Mullizës
 - Liqeni i Degës
 - Liqeni i Bazit
 - Liqeni i Çestijës
 - Liqeni i Gropës Madhe


- Dega kryesore nr.3, nga rezervuari kryesore – poshte majes se Madhe Deshiran.

Kjo linje kalon nga nga rezervuari ne lumin Devoll ne afersi te fshatit Lumas, ku deri ne afersi te fshatit Gjyrale shkon paralel me dy deget e tjera nr.1 dhe nr.2 me pas kalon afer Liqenit te Ulzes dhe Kamenecit duke vazhduar ne afersi te fshatit Grekan, Gjolene per te perfunduar ne afersi te fshatit Deshiran poshte majes se Madhe ne kuoten +185m, ku do te ndertohej rezervuari nr.3. Gjatesia e kesaj linje parashikohet te jete $L= 16300\text{ml}$.

Kjo dege do te furnizoje me uje ndermjet linjave tercjale tokat dhe liqenet (para fillimit te sezonit te ujitjes dhe ne perjudhat qe nuk perdoret uji per ujitje) ne drejtimin e gjurmes se saj.

Kjo linje mund te furnizoje me ane te linjave tercjale liqenet e me poshtem:

- Liqeni i Godes
- Liqeni i Ulzes
- Liqeni i Miloshit
- Liqeni i Kashaj
- Liqeni i Katund
- Liqeni i Kamenecit
- Liqeni i Bieit
- Liqeni i Rimonit
- Liqeni i Marines
- Ujembledhesi i Marines
- Liqeni i Gurrasit
- Gjoli i Xhiklazit
- Ujembledhesi i Deshiranit



Kordinatat	e vepres			
	Fillim		Mbarim	
	X	Y	X	Y
Vepra e marrjes	A		418333.153	4537166.094

<i>Linja</i>	<i>A- Rk</i>	<i>418333.153</i>	<i>4537166.094</i>	<i>417417.601</i>	<i>4536586.289</i>
<i>Linja nr1</i>	<i>Rk - Rs1</i>	<i>417417.601</i>	<i>4536586.289</i>	<i>409795.478</i>	<i>4525446.125</i>
<i>Linja nr2</i>	<i>Rk - Rs2</i>	<i>417417.601</i>	<i>4536586.289</i>	<i>403306.987</i>	<i>4528023.545</i>
<i>Linja nr3</i>	<i>Rk - Rs3</i>	<i>417417.601</i>	<i>4536586.289</i>	<i>403233.807</i>	<i>4538201.521</i>

A - vepra e marrjes

Rk - Rezervuari kryesore

Rs1 Rezervuari sekondare nr 1

Rs1 Rezervuari sekondare nr 2

Rs1 Rezervuari sekondare nr 3

8. HARTIMI I PROJEKTIT

❖ Standardet

Projekti per **“NDERTIMI I SISTEMIT VADITES ME SISTEME POMPASH,DEPO SHPERMDARJEJE DHE LINJA ME VETE RRJEDHJE”**,duhet të hartohet mbështetur dhe në zbatim të *Planit te Pergjithshem Vendor sipas akteve ligjore apo nënligjore në fuqi për Kushtet Teknike të Projektimit*duke marrë në konsideratë kushtet dhe kriteret e veçanta në rastin e projektimit apo zbatimit tëndertimi te rrugeve rurale, të marrë në konsideratë Kushtet Teknike të Zbatimit që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë si dhe Standardet në fuqi për normat dhe kriteret specifike të projektimit si dhe ndjekja e procedurave deri në miratimin e lejes së ndërtimit.

Eshtë përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse. Projektuse te marr ne konsiderate edhe standardet europiane EN/ISO, udhëzimet teknike të FAO-s, si dhe legjislacionin e Bashkimit Europian për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore. Zbatimi i këtyre standardeve garanton funksionim të sigurt, eficiencë të lartë hidraulike dhe mbrojtje të mjedisit. Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standareve të reja si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

Hartimi i preventivit do të realizohet në përputhje me cmimet e referencës do të jenë sipas legjislacionit në fuqi (Manuali Teknik i Çmimeve V.K.M nr.216, datë 13.04.2023).

❖ Dorëzimi i Projektit

Dorzimi i Projektit të përmbyllet brenda një afati prej 180 ditësh. Pas dorëzimit të projekt - idesë priten komentet nga autoriteti kontraktor, brenda 15 ditëve nga dorëzimi i saj.

Afati i parashikuar për komente nga Autoriteti Kontraktor nuk përfshihet në afatin e realizimit të shërbimit nga konsultenti.

Projekti zbatimi do të përmbajë të gjithë materialin e përmendur mësipër.



përmbajë:

Dokumentacioni përfundimtar duhet të

- Azhornimi topografik/gjeodezik sipas kërkesave te projektit ne kete detyre projektimi ne formatin A2;
- Tabela volumeve, profilet gjatesore dhe terthore sipas kërkesave te projektit ne kete detyre projektimi ne formatin A3;
- Projektin Hidrotekniksipas kërkesave te projektit ne kete detyre projektimi ne formatin A3;
- Projektin elektrik/mekanik sipas kërkesave te projektit ne kete detyre projektimi ne formatin A3;
- Projektin konstruktiv;
- Planvendosja e objektit ne shkallen 1:1000 format A3;
- Plan Rilevimi formati A3;
- Relacioni Hidrologjik;
- Relacioni Konstruktiv;
- Relacioni Hidroteknik;
- Relacioni Gjeologjik;
- Relacioni Topografik;
- Relacion elektrik/mekanik;

- Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen dhe rekomandime për materialet e ndërtimit që do të përdoren;
- Raport i VNM-se i Miratuar nga Agjencia Kombetare e Mjedisit;
- Preventiv;
- Analiza të çmimeve;
- Grafik i punimeve;

Gjithashtu projektuesi duhet të paraqesë:

- Liçenca e inxhinierit Hidroteknik + Deklarata e Pergjegjesise Profesionale + Polica e Sigurimit;
- Liçenca e inxhinierit gjeolog + Deklarata e Pergjegjesise Profesionale + Polica e Sigurimit;
- Liçenca e inxhinierit konstruktor + Deklarata e Pergjegjesise Profesionale + Polica e Sigurimit;
- Liçenca e inxhinierit te mjedisit + Deklarata e Pergjegjesise Profesionale + Polica e Sigurimit;
- Liçenca e inxhinierit topograf + Deklarata e Pergjegjesise Profesionale + Polica e Sigurimit;
- Liçenca e inxhinierit elektrik/mekanik + Deklarata e Pergjegjesise Profesionale + Polica e Sigurimit;

❖ Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdore cdo dokumentacion ekzistues në lidhje me gjurmen ekzistuese do të ndërtohet ky objekt.
- Konsulentit do t'i vihet në dispozicion të gjitha dokumente e nevojshme te parcelave qe do te duhet te mbulohen nga sistemi vadites.
- Cilësia e projektimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standartin e kërkuar.
- Projektuesi duhet të hartojë projektin në përputhje me Ligjin nr.8402, datë10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Ligjin 107/2014 “per planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar.

❖ Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin Kontraktor. Stafi që kërkohet duhet të mbulojë:

- Inxhinier Hidroteknik
- Inxhinier Gjeologjik
- Inxhinierkonstruktor;
- Inxhinier Topograf/Gjeodet
- Inxhinier Mjedisi
- Inxhinier elektrik/mekanik;
- Staf mbështetës për fushat e mësipërme;

❖ Stafi per projektim

KAT 3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

- a) - Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton
arme deri në 5 kate.

Kat 4. PROJEKTUES INSTALATOR

c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

KAT 5. PROJEKTUES VEPRA HIDOTEKNIKE:

b)- Furnizim me uje-kolektore shkarkimi.

g) - Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.

d)- Vepra ujitje – kullimi – impiante vaditëse – diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) – damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.

f)- Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi- shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse.

Kat 8. PROJEKTUES GJEODET:

a) – Rilevime inxhinierike.

c) – Sistemet GIS.

d) – Bazamente gjeodezike.

Kat 9. PROJEKTUES GJEOLIGO-INXHINIERIK-HIDROLOGJIK

e) - Studime e projekte hidrogjeologjike.

PROJEKTUES MJEDISI

Certifikuar/Licensuar si specialist për vlersimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor.



Detyrat kryesore të projektuesve perkates;

-Inxhinieri konstruktor

Detyrat specifike:

- ✓ Projektimi i strukturave beton-arme me/pa pranitë e ujit.
- ✓ Vlerësimi i ngarkesave në tubacionet, puseta apo dhoma kontrolli.

Profili i Ekspertit:

- ✓ Diplomuar në inxhinieri ndërtimi/strukturist
- ✓ Të posedoj Liqensë me kategorinë përkatëse
- ✓ Përvojat e ngjashme me kërkesat për projektimin e betoneve mix përmbrojtje konkrete për t'ibërë ballë me kushte të mëdha dhe agresive

-Inxhinieri Elektrik/Mekanik

Detyrat specifike:

- ✓ Projektimi për impiantet elektrike, mekanike, stacionet e pompimit, makinerive, paisjeve për jo vetëm të kufizuara të
- ✓ Specifikimi i kërkesave elektrike / mekanike për impiantet elektrike, mekanike stacionet e pompimit, makinerive, paisjeve për jo vetëm të kufizuara të.
- ✓ Përgatitja e preventiv dhe analizat e kostos për pajisje elektrike-mekanike
- ✓ Hartimin e relacionit teknik për elektrike-mekanike
- ✓ Hartimi i specifikimeve teknike elektrike-mekanike

Profili i Ekspertit:

- ✓ Diplomuar në inxhinieri elektrike
- ✓ Të posedoj Liqensë me kategorinë përkatëse
- ✓ Përvojë të ngjashme të punës në inxhinieri elektrike-mekanike në sektorin e ujit
- ✓ Përvojë praktike në projektimin e stacioneve të pompimit

-Inxhinieri Hidraulik

Detyrat specifike:

- ✓ Koordinimi i përgjithshëm i mbështetjes dhe ekspertizës në kuadër të projektit.
- ✓ Shqyrtimi dhe miratimi i punës së ekspertëve të ekipit dhe integrimi e punës së përgjithshme të projektimit.

- ✓ Ofrimi i mbështetjes me ekspertë në lidhje me shërbimin në aspektet teknike, ligjore, operacionale, sidheqështjetë specializuara, të tilla si sistemet teknike etj.
- ✓ Specifikimi i kërkesave hidroteknike për të gjitha komponentet e ujit.
- ✓ Përgatitja e preventivëve dhe analizat e kostos.
- ✓ Hartimin e relacionit teknik.
- ✓ Hartimi i specifikimeve teknike.

Profili i Ekspertit:

- ✓ Diplomuar për Inxhinieri hidroteknik/ndërtimi.
- ✓ Përvojë e ngjashme në projektimin e zbatimit të rrjetit me furnizim-ujtje.
- ✓ Njohje e projektimit të stacionit të pompimit nga të dy aspektet strukturore dhe elektromekanike.

-Inxhinieri Gjeodet

Detyrat specifike:

- ✓ Hartimi i planeve profileve të rrethit të theksuar të topografike me kuotadhe hartave GIS Njohja me planet topografike ekzistuese për rrjetet e ujës që jellën savenë zonat e zhvilluara

Profili i Ekspert:

- ✓ Diplomuar në Inxhinier profile gjeodet / topograf/markshnaider
- ✓ Të posedoj Liçensë me kategorinë përkatëse
- ✓ Përvojë ngjashme të punëve topografike
- ✓ Përvojë praktike e software përkrijimin e hartave Gis

-Inxhinieri Gjeolog

Detyrat specifike:

- ✓ Të këshillojë mbështetjet e tabanit që ndikojnë në projektimin dhe integritetin e rrjetit të furnizimit me ujë dhe strukturat e lidhura me to
- ✓ Të këshillojë mbështetjet gjeoteknike lidhje me gërmimet e thella, kalimet e ndryshme.
- ✓ Hartimin e relacionit gjeologjik
- ✓ Hartimin preventiv dhe analizat e çmimeve

Profili i Ekspert:

- ✓ Diplomuar në Inxhinier profile gjeolog
- ✓ Të posedoj Liçensë me kategorinë përkatëse
- ✓ Përvojë ngjashme të studimeve hidrogeologjike

-Inxhinieri mjedisit

Detyrat specifike:

- ✓ Raportin teknik të projektit të propozuar
- ✓ Raportin parapraktë VNM-së,
- ✓ Aplikimin për deklaratë mjedisore

Profili i Ekspert:

- ✓ Çertifikuar/Licencuar në Mjedis
- ✓ Të posedoj Liçensë me kategorinë përkatëse
- ✓ Përvojë në projektet për vlerësimin mjedisor

Raportimi/paraqitja

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të merren parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji 107/2017 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshaur, dhe dispozitat nënligjore në zbatim të tij si dhe ndjekjen e procedurave ligjore deri në miratimin e Lejes së Ndërtimit nga Autoritetet.

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 5 (pesë) kopje, në gjuhën shqipe dhe të jenë te printuar me ngjyra. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin “DWG” (AutoCad 2006-2025).

Ne projekt do te paraqiten te gjitha detajet, skicat dhe udhezimet e domosdoshme per realizimet e punimve.

Ne projekt do te shenohet vend - depozitimi i mbetjeve dhe treguesit e distancave nga secili rruge deri tek venddepozitimi i mbetjeve.

Të gjitha materialet do të dorëzohen në hard-copy (në 5kopje te firmosur dhe vulosur me vule te njome) si dhe te dorezohet i vulosur elektronikisht me vule dixhitale nga projektuesit drejtuesiligjor.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 10.*

b. Sigurimin e Ofertës, *sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas përcaktimeve të bera në Shtojcën 9 të DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022-2023-2024**, ku vlera e xhiros për të paktën

një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet

"Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor"...

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të maturuara të parashikuara nga Pushteti Vendor për **vitin 2025 sipas Ligjit** Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar);prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shënim: *Në procedurat e prokurimit me një fazë," përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i" dhe "j", të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë **jo më të vogël se 40 %** të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohet kontrata, vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore,

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë, Liçences profesionale për shoqërinë, sipas VKM nr. 943, date 28.12.2016, e vlefshme për kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim lëshuar nga MIE dhe/ ose MZHU dhe/ose nga cdo Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim , për këto kategori:

KAT 3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a)- Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

KAT 4. PROJEKTUES INSTALATOR

c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

KAT 5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

b)- Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

d)- Vepra ujitje – kullimi – impiante vaditëse – diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) – damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.

e)- Vepra të trajtimit të ujit. Kjo kategori jepet vetëm për personat juridikë (shoqëri/studio).

f)- Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi- shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse.

KAT. 8. PROJEKTUES GJEODET

- a) – Rilevime inxhinierike.
- c) – Sistemet GIS.
- d) – Bazamente gjeodezike

KAT. 9. STUDIM GJEOLIGO INXHINIERIK – HIDROLOGJIK

d)– Studime e projekte hidrogjeologjike.

Inxhinier Mjedisi

Çertifikuar/Licencuar si specialist për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë te punësuar mesatarisht të paktën **6 (gjashte) punonjës** për periudhën **Janar 2026 – Mars 2026**.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, për periudhën e fundit të deklaruar ,ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar;
- b) Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhën e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.
....”

